

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2022

Lënda : Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj dt 31.08.2022 ardhur pranë KESH sh.a.me nr prot :4229:

Përgjigje sqaruese nga KESH sh.a. dt.07.10.2022:

Pyetja B-1 (a, b dhe c).

Sjellim në vëmendjen tuaj se për sa i përket raporteve dhe aktiviteteve të cituara nga ana juaj (raportet e studimeve hidrologjike, sedimentare, sizmologjike, gjeologjike dhe gjeoteknike së bashku me studimet e raportet e nevojshme për ndikimet sociale dhe mjedisore) kontraktori është në fazën e hartimit të dokumentacionit dhe kryerjes së studimeve të nevojshme në terren dhe për rrjedhojë nuk disponojmë ende një raport përfundimtar për ta vënë në dispozicion të palëve të interesit.

Produktet e fazës së parë do të përgatiten dhe më pas aprovohen sipas parashikimeve të nenit 5 të Ligjit 38/2021 dhe VKM 485, datë 30.07.2021. Pas kësaj, këto produkte dhe dokumentacioni i tyre mbështetës do të vihen në dispozicion të palëve të interesuara.

Dëshirojmë po ashtu të theksojmë se në fazën ku ndodhemi nuk ka ende një vendimmarrje mbi projektin përfundimtar dhe aktivitetet e kësaj faze të parë kanë për qëllim mundësimin e marrjes së vendimeve bazuar mbi të dhëna teknike, ekonomike, mjedisore e sociale.

Sqarojmë si edhe në përgjigjet që ju kemi kthyer edhe më herët se në tërësi informacioni i mbledhur për projektin do të vihet në dispozicion të publikut në fazën e tij përfundimtare dhe pas miratimit. Dokumentacioni i cili përbën të dhëna të mbledhura në kuadër të kërkim do të bëhet i disponueshëm në bibliotekat e vendit pasi të klasifikohet si përfundimtar.

Pyetja B-2 (a, b)

Një nga aktivitetet e fazës së parë të projektit është edhe realizimi i studimeve të nevojshme gjeologjike e gjeo-teknike për të përcaktuar alternativat e vendndodhjes së digës dhe elementeve të tjera të projektit. Realizimi i këtyre aktiviteteve kërkon edhe sondimin gjeologjik e gjeo-teknik në pika të ndryshme në zonën e projektit. Ky është një aktivitet që kryhet në kuadër të projektimit

të çdo veprë infrastrukturore. Me qëllim realizimin e këtyre studimeve, ka qenë e nevojshme që mjetet që realizojnë sondimin gjeoteknik të shkojnë në zona të projektit ku mungon aksesimi për mjetet përkatëse. Për këtë arsye, është dashur që të sigurohet ky akses, duke hapur rrugë të reja aksesimi ose duke përmirësuar ato ekzistuese. Pra, punimet civile që janë kryer në zonë lidhen ngushtësisht vetëm me fazën e parë të studimeve inxhinierike në funksion të vlerësimit inxhinierik të alternativave.

Këto punime janë kryer në kuadër të kontratës me kompaninë Bechtel dhe angazhimit të kontraktorëve e nënkontraktorëve lokalë.

Për këtë aktivitet, KESH ka marrë miratimin e Këshillit Kombëtar të Territorit në mbledhjen e datës 20.04.2022.

Faleminderit!